



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.28**

**29 shkurt**

**2008**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9873,  
datë 14.2.2008

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen  
europiane për linjat e rëndësishme ndërkombëtare të transportit  
të kombinuar dhe instalimet përkatëse (AGTC)” ..... 1305

**LIGJ**  
**Nr.9873, datë 14.2.2008**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN EUROPIANE  
PËR LINJAT E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE TË TRANSPORTIT TË  
KOMBINUAR DHE INSTALIMET PËRKATËSE (AGTC)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen europiane për linjat e rëndësishme ndërkombëtare të transportit të kombinuar dhe instalimet përkatëse (AGTC)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5633, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

ECETRANS/88.REV3

**KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN**  
**KOMITETI PËR TRANSPORTIN TOKËSOR**

**MARRËVESHJA EUROPIANE**  
**MBI LINJAT E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE TË TRANSPORTIT TË KOMBINUAR**  
**DHE INSTALIMET PËRKATËSE (AGTC)**  
**PËRFUNDUAR NË GJENEVË MË 1 SHKURT 1991**

Shënim.

Ky dokument përmban tekstin e Marrëveshjes së AGTC-së, përfshirë procesverbalin e korigjimeve, siç është njoftuar në Lajmërimin e Depozitarit C.N.347.1992. TRAKTATE-7, datë 30 dhjetor 1992 dhe amendamentet e mëposhtme në Marrëveshjen AGTC:

- a) Lajmërimet e Depozitarit C.N.345.1997. TRAKTATE-2 dhe C.N.91.1998. TRAKTATE-1, i cili ka hyrë në fuqi më 25 qershor 1998.
- b) Lajmërimi i Depozitarit C.N.230.2000. TRAKTATE-1 dhe C.N.983.2000. TRAKTATE-2, i cili ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2001.
- c) Lajmërimi i Depozitarit C.N.18.2001 TRAKTATE-1 dhe C.N.877.2001. TRAKTATE-2, i cili ka hyrë në fuqi më 18 dhjetor 2001.
- d) Lajmërimi i Depozitarit C.N. 749.2003. TRAKTATE-1 dhe C.N.39.2004. TRAKTATE-1, i cili ka hyrë në fuqi më 16 prill 2004.
- e) Lajmërimi i Depozitarit C.N.724.2004. TRAKTATE-1 dhe C.N.6.2005998. TRAKTATE-1, i cili ka hyrë në fuqi më 7 prill 2005.

Ky dokument përmban në një dokument të vetëm, jozyrtar, tekstin e konsoliduar të Marrëveshjes AGTC që përfshin instrumentin bazë, amendamentet dhe korrigjimet e tij që kanë hyrë në fuqi në datat e shënuara. Vetëm teksti i ruajtur nën kujdesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në cilësinë e tij si Depozitar i Marrëveshjes AGTC, përbën tekstin e besueshëm të Marrëveshjes AGTC.

## **MARRËVESHJA EUROPIANE** **MBI LINJAT E RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE TË TRANSPORTIT** **TË KOMBINUAR DHE INSTALIMET PËRKATËSE (AGTC)**

Palët Kontraktuese,  
*duke dëshiruar* të lehtësojnë transportin ndërkombëtar të mallrave;  
*të informuara* për rritjen e pritshme të transportit ndërkombëtar të mallrave, si rezultat i zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare;  
*të vetëdijshme* për pasojat e pafavorshme mjedisore që mund të sjellin zhvillime të tilla;  
*duke theksuar* rolin e rëndësishëm të transportit të kombinuar në lehtësimin e ngarkesës në rrjetin rrugor europian, veçanërisht në trafikun transalpin, si edhe në zbutjen e dëmeve mjedisore;  
*të bindura që*, në mënyrë që ta bëjnë transportin e kombinuar ndërkombëtar në Europë më eficient dhe tërheqës për klientët, është thelbësore të hartohet një kuadër ligjor, i cili do të përcaktojë një plan të kombinuar për zhvillimin e shërbimeve të transportit të kombinuar dhe infrastrukturës së nevojshme për operimet e tyre, bazuar në parametrat dhe standardet e performancës, të miratuara në nivel ndërkombëtar;  
*kanë rënë dakord* si më poshtë:

### **KAPITULLI I** **TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1** **Përkufizime**

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

a) Termi “transport i kombinuar” nënkupton transportin e mallrave në një dhe të njëjtën njësi transporti, duke përdorur më shumë se një mënyrë transporti.

b) Termi “rrjeti i linjave të rëndësishme ndërkombëtare të transportit të kombinuar” i referohet të gjitha linjave hekurudhore, që konsiderohen të rëndësishme për transportin e kombinuar ndërkombëtar, në qoftë se:

i) ato aktualisht përdoren për transport të kombinuar të rregullt ndërkombëtar (p.sh. kontenier ngarkesash të lehta, kontenier, gjysmëtrajler);

ii) ato shërbejnë si linja të rëndësishme ushqyese për transportin e kombinuar ndërkombëtar;

iii) ato priten të jenë linja të rëndësishme të transportit të kombinuar në të ardhmen e afërt (si është përcaktuar në i) dhe ii)).

c) Termi “instalime përkatëse” i referohet terminaleve të transportit të kombinuar, pikave të kalimit kufitar, stacioneve të ndërrimit të grupeve të vagonëve, stacioneve të këmbimit të shinave dhe lidhjeve/porteve të trageteve, të cilat janë të rëndësishme për transportin e kombinuar ndërkombëtar.

#### **Neni 2** **Përcaktimi i rrjetit**

Palët Kontraktuese miratojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje si një plan të koordinuar ndërkombëtar për zhvillimin dhe operimin e rrjetit të linjave të rëndësishme të transportit të kombinuar ndërkombëtar dhe instalimeve përkatëse, më poshtë të referuara si “rrjeti i transportit të

kombinuar ndërkombëtar”, të cilin ato synojnë ta ndërmarrin brenda kuadrit të programeve kombëtare. Rrjeti i transportit të kombinuar ndërkombëtar përbëhet nga linjat hekurudhore të përfshira në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje, si edhe të terminaleve të transportit të kombinuar, pikave të kalimit kufitar, stacioneve të ndërrimit të grupeve të vagonëve, stacioneve të këmbimit të shinave dhe lidhjeve/porteve të trageteve të rëndësishme për transportin e kombinuar ndërkombëtar, që përfshihen në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

### **Karakteristikat teknike të rrjetit**

Linjat hekurudhore të rrjetit të transportit të kombinuar ndërkombëtar duhet të përshtaten me karakteristikat e përshkruara në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje ose duhet të përshtaten me dispozitat e këtij aneksi gjatë punës përmirësuese që do të kryhet në të ardhmen, në pajtim me programet ndërkombëtare.

Neni 4

### **Qëllimet operacionale**

Për të lehtësuar shërbimet e rrjetit të transportit të kombinuar ndërkombëtar, Palët Kontraktuese duhet të marrin masa të përshtatshme për të arritur parametrat e performancës dhe standardet minimale për trenat e transportit të kombinuar dhe instalimeve përkatëse, të referuara në aneksin IV të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

### **Anekset**

Anekset e kësaj Marrëveshjeje formojnë një pjesë përbërëse të Marrëveshjes. Anekset e mëtejshme, që do të mbulojnë aspekte të tjera të transportit të kombinuar, mund t’i shtohen kësaj Marrëveshjeje, sipas procedurës së amendamentit të përshkruar në nenin 14.

## **KAPITULLI II DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 6

Kjo Marrëveshje duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

### **Nënshkrimi**

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur në zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë për nënshkrim nga Shtetet, të cilat janë anëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën ose janë pranuar në Komision në cilësi konsultative, sipas paragrafëve 8 dhe 11 të termave të referencës së Komisionit, nga 1 prilli 1991 deri më 31 mars 1992.

2. Nënshkrime të tilla do të jenë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi.

Neni 8

### **Ratifikimi, pranimi ose miratimi**

1. Kjo Marrëveshje do të jetë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7.

2. Ratifikimi, pranimi ose miratimi do të kryhen nga depozitimi i një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 9 **Aderimi**

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga çdo shtet i referuar në paragrafin 1 të nenit 7 nga 1 prilli 1991.

2. Aderimi do të bëhet nga depozitimi i një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 10 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës në të cilën qeveritë e tetë Shteteve depozitojnë një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, me kusht që një ose më shumë linja të rrjetit të transportit të kombinuar ndërkombëtar të lidhin, në mënyrë të vazhdueshme, territoret e të paktën katër Shteteve, të cilat kanë depozituar një instrument të tillë.

2. Në qoftë se kushti i mësipërm nuk përmbushet, Marrëveshja duhet të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të të cilit do të përmbushet kushti i përmendur.

3. Për çdo Shtet, që depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pas fillimit të periudhës prej 90 ditësh të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Marrëveshja do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të përmendur.

#### Neni 11 **Kufijtë e zbatimit të Marrëveshjes**

1. Asnjë pjesë e kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të parandalojë një Palë Kontraktuese të ndërmarrë një veprim që është në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të kufizuar nga ekzigjencat e situatës, që ajo i çmon të nevojshme për sigurinë e saj të jashtme dhe të brendshme.

2. Masa të tilla të cilat duhet të jenë të përkohshme, duhet t'i njoftohen menjëherë Depozitarit dhe natyra e tyre duhet të specifikohet.

#### Neni 12 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy apo më shumë Palëve Kontraktuese, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të cilën Palët në konflikt nuk janë në gjendje ta zgjidhin me negociata apo mënyra të tjera, duhet të referohet për arbitrazh, në qoftë se këtë e kërkon njëra nga Palët Kontraktuese në konflikt, dhe në fund të dorëzohet te një ose me shumë gjyqtar arbitrazhi të zgjedhur në marrëveshje të ndërsjella ndërmjet Palëve në konflikt. Në qoftë se Palët në konflikt nuk bien dakord për zgjedhjen e një gjyqtari arbitrazhi apo gjyqtarëve arbitrazhi, brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh, një nga këto Palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojë një gjyqtar të vetëm arbitrazhi, të cilit duhet t'i dorëzohet debati për vendim.

2. Shpërblimi i gjyqtarit të arbitrazhit apo gjyqtarëve të arbitrazhit, të caktuar në bazë të paragrafit 1 të këtij neni do të varet nga Palët Kontraktuese në konflikt.

Neni 13  
**Rezerva**

Në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose të depozitimit të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi, çdo shtet mund të njoftojë Depozitarin që ajo nuk e çmon veten të lidhur nga neni 12 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14  
**Amendamenti i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje mund të amendohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë nen, me përjashtim të rasteve të parashtruara në nenet 15 dhe 16.

2. Me kërkesë të një Pale Kontraktuese, çdo amendament që ajo ka propozuar për këtë Marrëveshje duhet të merret në konsideratë nga Pala Aktive në Transportin e Kombinuar të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën.

3. Në qoftë se amendamenti miratohet me shumicën e dy të tretave të Palëve Kontraktuese të pranishme që votojnë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet t'ua komunikojë amendamentin të gjitha Palëve Kontraktuese për pranim.

4. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të hyjë në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës 12-mujore nga data e komunikimit të tij, me kusht që gjatë kësaj periudhe 12-mujore, një Shtet që është Palë Kontraktuese nuk e njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për ndonjë kundërshtim të amendamentit të propozuar.

5. Çdo amendament pranuar në këtë mënyrë do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të të gjitha Palët Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së komunikimit të tij nga Depozitari.

6. Në qoftë se deklarohet një kundërshtim për amendamentin e propozuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, amendamenti do të gjykohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë lloj efekti.

Neni 15  
**Amendamenti i anekseve I dhe II**

1. Anekset I dhe II të kësaj Marrëveshjeje mund të amendohen në përputhje me procedurën e paraqitur në këtë nen.

2. Me kërkesë të një Pale Kontraktuese, çdo amendament i propozuar nga ajo për anekset I dhe II do të merret në konsideratë nga Pala Aktive në Transportin e Kombinuar të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën.

3. Në qoftë se amendamenti i miratuar nga shumica e Palëve Kontraktuese të pranishme dhe votuese, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet t'ua komunikojë amendamentin e propozuar të gjitha Palëve Kontraktuese të interesuara direkt për pranim. Për qëllim të këtij neni, një Palë Kontraktuese quhet direkt e interesuar, në rast të përfshirjes së një linje të re, një terminali të rëndësishëm, një pike kalimi kufitar, një stacioni për ndërrimin e shinave ose një lidhjeje porti tragetesh, ose në rastin e modifikimeve përkatëse, kjo linjë kalon në territorin e saj, ose është direkt e lidhur me terminalin e rëndësishëm, ose në qoftë se terminali i rëndësishëm, pika e kalimit kufitar, stacioni i ndërrimit të shinave ose pika terminale e lidhjes/portit të trageteve ndodhen në territorin e sipërpërmendur.

4. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni do të gjykohet i pranuar, në qoftë se brenda një periudhe gjashtëmujore nga data e komunikimit të tij nga Depozitari, asnjë nga Palët Kontraktuese të interesuara, drejtpërdrejt e interesuar, nuk ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për mos pajtimin e saj me amendamentin e propozuar.

5. Çdo amendament i pranuar do të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të gjitha Palët Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi tre muaj nga data kur Depozitari e ka komunikuar atë.

6. Në qoftë se një mospajtim me amendamentin e propozuar njoftohet në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, amendamenti do të gjykohet që nuk është pranuar dhe nuk do të ketë asnjë lloj efekti.

7. Depozitari duhet të njoftohet menjëherë nga Sekretariati i Komisionit Ekonomik për Europën rreth Palëve Kontraktuese, që janë drejtpërdrejt të interesuara për amendamentin e propozuar.

#### Neni 16

#### **Amendamenti i anekseve III dhe IV**

1. Aneksat III dhe IV të kësaj Marrëveshjeje mund të amendohen në përputhje me procedurën e paraqitur në këtë nen.

2. Me kërkesë të një Pale Kontraktuese, çdo amendament propozuar nga ajo për anekset III dhe IV do të merret në konsideratë nga Pala Aktive në Transportin e Kombinuar të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën.

3. Në qoftë se amendamenti miratohet nga shumica e dy të tretave të Palëve Kontraktuese të pranishme dhe votuese, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'ua komunikojë amendamentin të gjitha Palëve Kontraktuese për pranim.

4. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do të gjykohet i pranuar, në qoftë se brenda një periudhe gjashtëmujore nga data e komunikimit të tij, një e pesta ose më shumë e Palëve Kontraktuese e ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për kundërshtimin e tyre në lidhje me amendamentin e propozuar.

5. Çdo amendament i pranuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni duhet të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Palët Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi tre muaj nga data e komunikimit për të gjitha Palët Kontraktuese përveç atyre që, para datës së hyrjes së tij në fuqi, kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm që nuk e kanë pranuar amendamentin e propozuar.

6. Në qoftë se një e pesta ose më shumë nga Palët Kontraktuese njoftojnë një kundërshtim për amendamentin e propozuar, në përputhje me paragrafin 4 të mësipërm, amendamenti do të gjykohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë lloj efekti.

(ECE/TRANS/88/Corr.1, i ndryshuar si më 20 shtator 1992)

#### Neni 17

#### **Klauzola e garancisë**

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të tejkalojnë dispozitat që disa Shtete mund të jenë të detyruara të zbatojnë midis tyre, në përputhje me traktate të tjera shumëpalëshe, si Traktati i Romës 1957, që ka themeluar Komunitetin Ekonomik Europian.

#### Neni 18

#### **Denoncimi**

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas datës kur Sekretari i Përgjithshëm ka marrë njoftimin e lartpërmendur.

Neni 19  
**Përfundimi**

Në qoftë se pasi kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi, numri i Palëve Kontraktuese do të jetë zvogëluar në më pak se tetë gjatë një periudhe prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm, Marrëveshja nuk do të ketë më efekt 12 muaj nga data në të cilën Shteti i tetë nuk do të jetë më Palë Kontraktuese.

Neni 20  
**Njoftimet dhe komunikimet nga depozitari**

Përveç njoftimeve dhe komunikimeve që mund të përcaktojë kjo Marrëveshje, funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara si Depozitar, do të paraqitet në Pjesën VII të Konventës së Vjenës mbi Ligjet e Traktateve, përfunduar në Vjenë më 23 maj 1969.

Neni 21  
**Tekstet origjinale**

Originali i kësaj Marrëveshjeje, tekstet e së cilës në anglisht, frëngjisht dhe rusisht janë njëllorj autentike, duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Përfunduar në Gjenevë më 1 shkurt 1991.

ANEKSI I

LINJAT HEKURUDHORE TË RËNDËSISHME PËR TRANSPORTIN E KOMBINUAR  
NDËRKOMBËTAR

(1) Portugalia \*/

C-E 05 (Fuentes de Onoro-) Vilar Formoso-Pampilhosa-  
Coimbra-Lisboa  
Porto

C-E 90 Lisbona-Entrocamento-Marvao (-Valencia de Alcantara)

-----

(2) Spanja \*/

C-E 05 (Hendaye-) Irun-Burgos-Medina del Campo-Fuentes de  
Onoro (-Vilar Formoso)

C-E 07 (Hendaye-) Irun-Burgos- Avila -Madrid  
Aranda de Duero

C-E 053 Madrid-Cordoba-Bobadilla-Algerciras

C-E 90 (Marvao-) Valencia de Alcantara-Madrid-Barcelona-Port  
Bou (-Cerbere)

C90/1 Valencia-Barcelona

Shënim i përgjithshëm dhe shpjegimi i numrave të linjave

“C-E” paraqet linjat hekurudhore në thelb identike me linjat përkatëse E të Marrëveshjes Europiane mbi Linjat Hekurudhore Ndërkombëtare Kryesore (AGC) të vitit 1985.

“C” paraqet linja të tjera të rëndësishme për transportin ndërkombëtar të kombinuar.

Numrat e linjës “C” janë identikë me ata që janë më afër linjës E dhe që disa herë vijnë me një numër serie.

Shkronja “E” është vendosur për referencë dhe krahasim më të lehtë me linjat që përmban AGC-ja. Kjo nuk tregon në asnjë mënyrë nëse Shtetet janë apo synojnë të jenë Palë Kontraktuese të AGC-së.

\*/ Simbolet e përdorura

( ) = Stacion jashtë vendit të interesuar, ëpër shembull: (Hendaye-)]

\_\_\_\_\_ = Rrugë alternative ëpër shembull: Avila  
Aranda de Duero]

----- = Seksioni i një linje të rëndësishme të AGC-së për transportin e kombinuar ndërkombëtar (ka të bëjë vetëm me linjat C-E).

..... = Seksioni i një linje të rëndësishme për transportin e kombinuar, por jo pjesë e linjës përkatëse AGC (ka të bëjë vetëm me linjat C-E).

-----  
(3) Irlanda \*/

C-E 03 (Larne-Belfast) —Dublin  
-----

(4) Britania e Madh \*/

C-E 03 Glasgou-Stranaer-Lame-Belfast(-Dublin)-Holyhead-Creue Carlisle

Londër-Folkston-Dover (-Kala)

C-E 16 London\_Harwick (-Zeebrugge)

C 03/1 Londër-Kardif

C 03/2 Cleveland-Donkaster-Londër

Leeds  
-----

(5) Franca \*/

\*/ Për shënimet e përgjithshme, shpjegimet e numrit të linjave dhe simbolet e përdorura, shih faqen 12

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

C-E 05 Paris-Bordo-Hendaye (-Irun) C-E07

C-E 15 (Quevv- Feiqnes -Aulnoye-Paris Dizhon -Lion-(Erquelinnes-).....

Zheumon Le Creusot

C-E 23 Dunderque-Aulnoye-Thionville-Metz-Frouard-Toul-Culmont

Chalindrey-Dizhon (-Vallorbe)

C-E 25 (Berremburg-) Thionville-Merz-Strasburg-Mulhauz-

(-Bazel) Belfort-Besançon -

Dizhon

C-E 40 Le Havre-Paris-Lerouville-

Onville-Metz-Remilly-Forbach

(- Saarbrucken)

C-E 42 Paris-Lerouville-Nansi-Sarreburg-Reding-Strasburg (-Kehl)

C-E 70 Paris-Macon-Amberieu-Culoz-Modane (-Torino)

CE-90 (Port Bou-) Cerbere-Narbonne-Taraskon-Marseje-Menton (-

Ventimilia)

C-E 700      Lion-Amberieu

\*/ Për shënimet e përgjithshme shpjegimet e numrit të linjave dhe simbolet e përdorura, shih faqen 11

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(5) Franca (vazhdimi)

C 07            Paris- Toulouse  
C 20            Lille-Tourcoing (-Mouscron)  
C 25            Thionville- Apach (-Perl)  
C 40            Paris-Le Mans-Nantes-Rennes  
C 51            (Dover-) Calais-Lille-Paris  
C 90/2         Bordo-Tuluz-Narbonne

---

(6) Hollanda \*/

C-E 15         Amsterdam-Den Hagë-Rotterdam Roosendaal (Antwerpen)  
C-E 16         (Haruic-) Hoek Van Holland-Rotterdam-Utrecht  
C-E 35         Amsterdam-Utrecht-Arnhem (-Emmerich)  
C 10/1         Utrecht-Amersfoort-Hengelo (-Bad Bentheim)  
C 16            Rotterdam-Tilburg-Venlo (Këln)

(7) Belgjika \*/

C-E 10)        (Dover-) Oostende-Bruksel-Liege (-Aachen)  
C-E 20)        (Roosendaal-) Antwerpen-Bruksel- Quevy (-Feignies)  
C-E 15         Charleroi-Erquillines(-Zhemont)  
C-E 22         (Haruic-) Zeebrugge-Brugge  
C-E 25         Bruksel-Arlon-Sterpenich (-Kleinbettingen)  
C 15            Charleroi-Namur-Liege  
C 20            (Tourcoing-) Mouscron-Liege-Montzen (-Aachen)

(8) Luksemburgu \*/

C-E 25         (Sterpenich)-Kleinbettingen-Luksemburg-Bettemburg (-Thionville)

\*/ Për shënimet e përgjithshme, shpjegimet e numrit të linjave dhe simbolet e përdorura, shih faqen 11.

(9) Gjermania \*/

C-E 10         (Liege-)Aachen-Këln-Dyseldorf-Dortmund-Mynster-Osnabryk-Bremen-  
Hamburg-Lybeck (-Hanko)  
C-E 18         Hamburg-Bychen-Berlin/Seddin  
C-E 20         (Liege-)Aachen-Këln-Duisburg-Dortmund-Hanover-Helmstedt-Berlin/Sedd  
in-Frankfurt (O) (-Kunouice)  
C-E 30         Dresden-Gyrlitz (-Zgorzelec)  
C-E 32         Frankfurt (M)-Hanau-Erfurt-Leipzig-Dresden

C-E 35	(Arnhem-)Emmerich-Duisburg-Dyseldorf-Köln-Mainz-Mannheim Karlsruhe- Dyseldorf-Neuss (-Basel)
C-E 40	(Forbach-) Saarbrycken-Ludwigshafen-Mannheim-Frankfurt (M)Germynden- Nyrenberg-Schirnding (-Cheb)
C-E 42	(Strasbourg-) Kehi-Appenuelier-Karlsruhe-Mvhlacker-Shtutgart Offenburg
C-E 43	Frankfurt(M)-Heidelbera-Bruchsal-Shtutgard-Ulm-AuQsbura-Mvnhen- Freilassing Mannheim (-Salzburg)
C-E 45	(Rodby-) Puttgarden-Hamburg-Hannover-Wurzburg-Nyrnberg-Ingolstadt- Mynhen (-Kufstein)
C-E 46	Mainz-Frankfurt(M)
C-E 51	(Gedser-) Rostock-Berlin- Halle Erfurt-Nyrnberg Laipcig
C-E 55)	(Trelleborg-) Sassnitz Hfen-Stralsund- Paseuok Berlin/Seddin-Dresden- Neustrelitz
C-E 61)	Bad Schandau (-Decin)
C-E 451	Nyrnberg-Passau (-Wels)
C 10/1	(Hengelo-) Bad Bentheim-Osnabryck
C 16	(Venlo-) Moenchengladbach-Köln
C 25	(Apach-) Perl-Trier-Koblenz
C 45/1	(Fredericia-) Flensburg-Hamburg
C 45/2	Bremerhaven-Bremen-Hanover
C 45/3	Travemynde-Lybeck

\*/ Për shënimet e përgjithshme, shpjegimet e numrit të linjave dhe simbolet e përdorura shih faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(10) Zvicra \*/

C-E 23	(Dizhon-) Vallorbe-Lausanne-Brig -----
C-E 25	(Mulhauz-) Bazel-Olten-Bern-Brig (-Domodosola)
C-E 35	(Karlsruhe-) Bazel-Olten-Chiaso (-Milano)
C-E 50	(Culoz-) Gjeneve-Lausanne-Bern-Zyrih-Buchs (-Innsbruk) -----
C 35	(Karlsruhe-) Bazel-Brugg-Immense-Bellinzona- (-Luino) Chiasso (-Milano)

11) Italia \*/

C-E 25	(Brig-) Domodosola-Novara-Milano-Xhenova
C-E 35	(Chiaso-) Milano-Bolonja-Firence-Roma-Napoli-Salerno-Vila S.Xhovani-Mesina -----
C-E 45	(Insbruk-) Brenero-Verona- Bolonja-Ankona-Foxhia-Bari-Brindisi
C-E 55	(Arnodstein-) Tarvisio-Udine-Venecia-Bolonja-Trieste -----

C-E 70 (Modane) Torino-Rho-Milano-Verona-Trieste-Vila Opicina (-Sezana)

---

\*/ Për shënime të përgjithshme, shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(11) Italia (vazhdon)

C-E 72 Torino-Xhenova  
C-E 90 (Menton-) Ventimiglia-Xhenova-Piza-Livorno-Roma  
C 35 (Bellinzona-) Luino-Gallaate-Rho-Milano  
C 90/1 La Spezia-Fidenca-Parma  
C 90/2 Livorno-Piza-Firence

(12) Norvegiia \*/

C-E 45 Oslo-(Kornsjo)  
C 47 Narvik (-Vasijuare)  
C 48 Trondheim-Hel (-Storlien)  
C 61 Oslo (Charlottenberg-Stokholm)

(13) Suedi

C-E 45 (Kornsjo-) Goteborg-Helsingborg (-Helsingor)  
C-E 53 Helsingborg-Hassleholm  
C-E 55) Stokholm-Hasleholm-Malmoe-Trelleborg (-Sasnitz Hafen)  
C-E 61)  
C-E 59 Malmoe-Ystad (-Szczecin)  
C 10/2 Stokholm (-Turku)  
C 45/1 Goteborg (-Grederikshavn)  
C 45/3 Malmoe (-Travemynde)  
C 47 Narvik (-Vasijaure)  
C 48 Trondehim-Hell (-Storlien)

(13) Suedi (vazhdon)

C 55 Hallsberg-Goteborg  
C 61 (Oslo-) Charlorrenberg-Karlstad-Hallsberg-Stokholm

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

14) Danimarka \*/

C-E 45 (Helsingborg-) Helsingr-Kobenhavn-Nykobing-Rodby (-Puttgarden)  
C-E 530 Nykobing-Gedser (-Rostock)  
C45/1 (Goteborg-) Frederikshavn-Arhus-Fredericia (-Flensburg) Kobenhavn

---

(15) Austria\*/

- C-E 43 (Freilassing-) Salzbur  
C-E 45 (Mynhen-) Kufstein-Wyrgl-Innsbruck (Brennero)  
C-E 50 (Buchs-) Innsbruck-VVyrgl-Kufstein (-Rosenheim-Freilassing)-  
Schäarzach St. Veit  
Linz-Viene- (-Hegveshalom) 1/  
Ebenfurt (-Sopron) 21  
<sup>1/</sup> MAV.  
<sup>2/</sup> GYSEV/MAV
- C-E 52 VVien-Marchegg (-Devinska Nova Ves)  
.....
- C-E 55 Linz-Salzburg-Schäarzach St.Veit-Villach-Arnoldstein (-Tarvisio)  
C-E 63 (Bratislava-) Kittsee-Parndorf-Viene  
.....
- C-E 65 (Breclav) Bernhardsthal-Wien-Semering-Bruck.a.d Mur-Klagenfurt-Villavh-  
Rosenbach (-Jesenice)  
C-E 67 Bruck a.d. Mur-Grac-Spielfeld Strass (-Sentilj)  
C-E 451 (Passau-) Wels  
C-E 551 (Horni-Dvoriste-) Summerau-Linz-Selzthat-St.Michael

---

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegim e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(16) Polonia

- C-E 20 (Frankfurt (0)-) Kunovice-Poznan-Lovicz- Varshava -Lukov- Terespol (-  
Brest) Skierniewice  
C-E 30 (Gyrlitz-) Zgorzelec Vroclav-Katovic-Krakov-Przemysl-Medyka (-Mostiska)  
.....
- C-E 59 Sëinoujscie-Szczecin-Kostrzy-Zielona Gora-Vroclav-Opole- Chalupki  
(-Bohumin)  
.....
- C-E 65 Gdynia-Gdansk-Tczew - Varshava- Katowica-Zebrzydovice (Petrovece U.  
Karvine)

-----Bydgoszcz -----

- C 30/1 Krakov-Novy Sacz-Myszyna (-Plave)  
C 59/1 Nova Sol-Zagan-Vegliniec-Zgorzelec-Zavidov (-Frydlant)  
C 59/2 Vroclav-Mieszylesie (-Lichkov)  
C-E 65/1 Zduska Vola Karsznice-Lod Oltechov-Skierniewice  
C-E 65/2 Chorzev Siemkovicze-Czestochova-Zawiercie-Javorzn Szczakova  
Czechovice Dziedzice  
C-E 65/3 Herby Nove-Paczyna-Kedzierzyn Ko le Azoty
-

17 a) Republika Çeke \*/

C-E 40 (Schirnding-) Cheb-Plze-Praga-Kolin-Hranica na Morav  
Ostrava-Mostv u Jablunkova (-adca)  
Horni Lide (-Luky pod Makytou)

-----

C-E 55 (Bad Schandau-) D in Praga  
C-E 59 (Chalupki-) Bohumin-Ostrava  
C-E 61 (Bad Schandau-) D in Nymburk-Kolin-Brno-B<sup>1</sup>eclav-Lanahot (-Kuty)  
C-E 65 (Zebrzydovice-)Petrovice u.Karvine-Ostrava-B<sup>1</sup>eclav  
(- Bernhard stahl)  
C-E 551 Praga-Horni Dvo ist (-Summerau)  
C 59/1 (Zavidov-) Frydlant-Turnov-Praga  
C 59/2 (Miedzylesie-) Lichkov .T “ebova

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(17 b) Sllovakia\*/

C-E 40 (Mostv u Jablunkova-Čadca Žilina-Poprad-Tatry-Kozice  
(Horni Lide-) Luky pod Makytou-Puchoc

-----

-Čierna nad Tisou (-Chop)

C-E 52 (Marchegg-) Devinska Nova Ves-Bratislava-Nove Zamky-Sturovo Szob)

-----

C-E 61 (Lanahot-) Kutv-Bratislava- Komarno (-Komarom)  
Rusovce (-Hegyeshalom)

-----

C-E 63 Žilina-Leopoldov-Bratislava (-Kittsee)  
Galanta  
C 30/1 (Muszyna-) Plave-Presov-Kysak-Kozice -a a (-Hidasnemeti)

(18) Hungaria

C-E 50 (Viena-) Hegyeshalom 1/ -Gyor-Budapest-Miskolc- Nyiregyhsza-Zhony  
(- Chop)  
(Ebenfurt-) Sopron 2/

-----

<sup>1/</sup> MAV.

<sup>2/</sup> GYSEV/MAY

C-E 52 (Sturovo-) Szob-Budapest-Cegled-Szolnok-Debrecen-Nyiregyhaza  
C-E 56 Budapest-Rakos-Ujszasz-Szolnok-Lykyshaza (-Curtici)  
C-E 61 (Bratislava-Komarno) Komarom-Budapest  
Hegyeshalom

.....

C-E 69	Budapest-Szekesfehervar- <u>Boba-Hodos</u> Murakeresztur (-Kotoriba)
C-E 71	Budapest-Dombovar-Gyekenyes (-Botovo-Koprivnica)
C-E 85	Budapest- Kelebia (-Subotica)
C-E 691	Murakeresztur- Gyekenyes

---

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(18) Hungaria (vazhdon)

C 30/1	(Čaña-) Hidasnemeti-Miskolc
C 54/1	(Episcopia Bihor-) Biharkereszttes-Berettyosjfalu-Püspökladiny
C 773	Budapest-Dombovar-Pecs-Magyarboly (-Beli Manastir)

---

(19) Jugosllavia \*/

C-E 65	(Rosenbach-) Jesenice-Lubjana-Pivka-Rijeka
C-E 67	(Spielfeld Strass-) Sentilj-Maribor-Zidani Most
C-E 69	(Murakeresztur-) Kotoriba-Pragersko-Zidani Most Lubjana-Divaca-Koper
C-E 70	(Vila Opicina-) Sezena-Lubjana-Zidani Most-Zagreb-Beograd-Nish-Dimitrovgrad (-Dragoman)
C-E 71	(Gyekenyes-) Botova-Koprivnica-Zabreb-Karlovac-Rijeka
C-E 85	(Kelebia-)Subotica-Beograd-Nish-Shkup-Gievjelja (-Idomeni) Kraljevo

(20) Greqia \*/

C-E 85	(Gjevjelja-) Idomeni-Selanik-Athina
C-E 855	(Kulata-) Promachon-Selanik
C 70/2	Strymonas-Aleksandropolis-Dikea (-Svilengrad)
C 85/1	Selanik-Follorina-Krestalopigi (.....)
C 85/2	Larisa-Volos- ëLatakia (Republika Arabe e Sirisë)]
C85/3	Igumenica-Kalabaka-Palaiofarsalos-Volos-ëLatakia (Republika Arabe e Sirisë)]
C 85/4	Athina-Patras

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv.Europiane 1992/ transporti i kombinuar

(21) Rumania\*/

C-E 54	Arad-Deva-Teius-Vinatori-Brasov-Bukuresht
C-E 56	(Lykyshaza-) Curtici-Arad-Timishuara-Krajova-Bukuresht
C-E 66	Halmeu-SatuMare-Karei-Oradea-Arad-Timishuara-Stamora Moravita(Vrsac)

---



-----

C-E 24	Moska-Ryazan-Ruzaevka-Samara-Ufa-Chelyabinsk-Kugan -Zauralie (-Persnogorkovkaja)
C-E 30	(Topoli-) Valuiki-Liski-Rtschevo-Sizran-Samara-Orenburg (-Iletsk I)
C-E 50	(Krasnaja Mogila-) Gukovo-Likhaja-Volgograd-Astrakhan(-Aksaraiskajall)
C-E 99	Moska-Rostov-na-Donu-Novorossiysk
C-E 102	Moska-Vogograd-Astrakhan
C-20/1	Saint Petersburg-Vologda-Kotelnich
C-20/2	Moska-Kazan-Ekaterinburg
C-20/3	Kaliningrad-Cheniakhovsk-Nesterov (-Kibartai)

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv. Europiane 1992/transporti i kombinuar

(25) Turqia \*/

C-E 70 (Svilangrad-) Kapikule-Stamboll-Haydarpara-Ankara- Bogazkypru-Kalin-  
Malatva- Kapiky r-Razi (Republika islamike e Iranit)1  
Nusaybin ë-Kamishli (Republika Arabe e Sirisë)]

C-E 74 Izmir -Balikesir-Alavunt- Afvon -Konya-Ulukisla  
Bandirma Eskisehir Usak-Manisa

C-E 97 (Ahurvan-) Dogukapi-Kars-Erzurum-Cetinkava-Kalin-Bogazkypry  
Uiukibla-Yenice Samsun

Adana- T. Kale - F. Pasa-Islahiye ë-Meydan Ekbez (Republika Arabe e  
Sirisë) Mersin Iskenderun .....

C 70/2 Pelivanky)-Uzunkypri (-Pythion)

---

(26) Kroacia \*/

C-E 65 (Ilirska Bistrica-) Sapjane-Rijeka  
C-E 69 (Murakerestzur-) Kotoriba- akovec (-Središće)  
C-E 70 (Dobova-)Savski Marof-Zagreb-Strizivojna Vrpolje-Vinkovci-Tovarnik (Sid)  
C-E 71 (Gyekenyes-) Botovo-Koprivnica-Zagreb -Karlovac-Ostarije-Rijeka  
C-E 751 Zagreb-Sunja-Volinja (-Dobrljin-Biha-Ripa-) Strmica-Knin- Split Sibenik  
C-E 753 Zagreb-Karlovac-Ostarije-Gospi-Knin-Zadar

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv. Europiane1992/transporti i kombinuar

(26) Kroacia (vazhdon)

C-E 771 (Bogojevo-) Erdut-Vinkovci-Strizivojna Vrpolje-Slavonski Samac (-  
Bosanski Samac-Sarajevë-apljina-) Metkovi -Ploce  
C710 (Sredise-) akovec-Varaadin-Koprivnica-Osijek-Erdut (-Subotica)  
C 773 (Magyarboly-) Beli Manastir-Osijek-Strizivojna Vrpolje

---

(27) Silovenia \*/

C-E 65 (Rosenbach-) Jesenice-Lubjana-Ilirska Bistrica (-Sapjane)  
C-E 67 (Spielfeld Strass-) Sentilj-Maribor-Zidani Most  
C-E 69 Hodos-Murska Sobota-Ormoz-Pragersko-Zidani Most-Lubjana-Divača  
Koper (Cakovec-) Sredisce  
C-E 70 (Vila Opicina-) Seaana-Lubjana-Zidani Most-Dobova (-Savski Marof)

---

(28) Bosnia Hercegovina \*/

---

(29) Shqipëria \*/

---

(30) Ish Republika Juqoslave e Maqedonisë \*/

---

(31) Biellorusia \*/

C-E 20 (Terespol-) Brest-Minsk-Orsha (-Krasnoye)

---

\*/ Për shenime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Kon. Europiane 1992/transporti i kombinuar

(32) Ukraina \*/

C-E 30 (Medyka-) Mostiska-2-Lvov  
C-E 40 (iern nad Tisou-) Chop  
C-E 50 (Zahony-) Chop-Lvov-Kiev-Khutor Mikhailovsky-Zernovo (-Suzemka)  
C-E 95 (Benderi-) Razdelnaja-Kazatin  
C-E 851 Lvov-Vadu Siret (-Vicsani)  
C 54 Chop-Deakovo (-Halmeu)

---

33) Republika e Moldavisë \*/

C-E 95 (lasi-) Ungeni-Kishivev-Benderi (-Razdelnaja)

---

\*/ Për shënime të përgjithshme, për shpjegimin e numrave të linjave dhe të simboleve të përdorura shihni në faqen 12.

Konv. Europiane 1992/transporti i kombinuar

## ANEKSI II

### INSTALIMET E RËNDËSISHME PËR TRANSPORTIN E KOMBINUAR NDËRKOMBËTAR

#### 1. Terminalet e rëndësisë së veçantë për transportin e kombinuar

##### AUSTRIA

Linz-Stadthafen	Wels Vbf
Messendorf	Vienë Freudenau Hafen
Salzburg Hauptbahnhof/Liefering	Vienë Norduestbahnhof
Villach Sud	

##### BELGIKA

Antwerpen	Genk (Hasselt)
Athus	Muizen (Mechelen)
Bressoux-Renory (Liezh)	Zeebrugge
Bruksel	

##### BULLGARIA

Burgas	Ruse
Dimitrovgrad Sever	Sofia
Filipovo	Stara Zagora
Gorna Oriahovitza	Varna

##### KROACIA

Rijeka	Split
Slavonski Brod	Zagreb

##### REPUBLIKA ÇEKE

Brno	Ostrava
Česke Budějovice	Plzeň
Cheb	Praga Ukrinėves
Jihlava	Praga Žizkov
Kolin	Pierov
Lovosice	

##### DANIMARKA

Arhus	Kobenhavn
Glostrup	Padborg

##### FINLANDA

Helsinki-Pasila

##### FRANCA

Avignon-Koutine	Paris-Noisy-Le-Sec
-----------------	--------------------

Bordo - Bastide  
Dunkerque  
Hendaye  
Le Havre  
Lille- St. Sauver  
Lion-Venissieux  
Marsejè-Canet  
Paris-La Chapelle

Paris-Pompadour  
Paris-Rungis  
Paris-Valenton  
Perpignan  
Rouen-Sotteville  
Strasbourg  
Tuluzè

#### GJERMANIA

Augsburg-Oberhausen  
Bazel Bad GBF  
Berlin  
Bielefeld Ost  
Bochum-Langendreer  
Bremen-Grolland Roland  
